



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1687 prot.

Tiranë, më 19. 12. 2024

V E N D I M

Nr. 310, datë 19. 12. 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën me nr. 233 Regj., datë 13.11.2024, që i përket ankuesit I. Gj., përfaqësuar pranë Komisionerit nga Avokat E. C., kundër Qendrës së Shërbimeve Arsimore², me pretendimin diskriminimin për shkak të *gjendjes arsimore dhe për çdo shkak tjetër*³.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri⁴,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar se: “*Kërkuesi ka nisur studimet rregullisht më datë 01.09.2007 dhe është regjistruar në programin e studimit “Bachelor” në Fakultetin e Inxhinieri Ndërtimi pranë Institucionit privat arsimor të lartë, Universitetit EPOKA. I. Gj. ka përfunduar studimet e nivelit Bachelor më datë 11.07.2011 dhe është lëshuar diploma më datë 20.09.2012. Në të njëjtën kohë ankuesi është regjistruar më datë 13.11.2015 në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit pranë Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në*

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën QSHA.

³ Pa përcaktuar një karakteristikë apo veçanti që ajo mban dhe që prezumohet të ketë ndikuar në sjelljen diskriminuese të pretenduar.

⁴ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Universitetin EPOKA. Pasi ka plotësuar kushtet për diplomim nga programi i studimit në fjalë më datë 17.04.2018, nuk është pajisur me dokumentacionin përkatës që vërteton përfundimin e studimeve. Megjithëse ankuesi I. Gj. ka përmbushur të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, ende nuk është pajisur me diplomën, ku kjo vonesë e pajustificuar i ka sjellë dëme të konsiderueshme, duke e penguar në zhvillimin e mëtejshëm profesional dhe në aplikimet për punë, në fushën dhe drejtimin për të cilin ka studiuar.

Ankuesi aktualisht ndodhet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku ky dokumentacion është i domosdoshëm për qëllime punësimi dhe përparimi profesional. Zvarritja, vonesa në lëshimin e diplomës dhe dokumenteve përkatëse përfundimtare i kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme profesionale ankuesit, duke e penguar të zhvillohet më tej në karrierë dhe të përmbush qëllimet e tija profesionale në çdo vend.

Referuar kërkesave të depozituara nga ankuesi më datë 04.07.2023, si dhe datë 19.08.2023, drejtuar QSHA-së na është komunikuar nëpërmjet shkresës, Nr. 2771/2 prot., datë 24.08.2023 “Kthim përgjigje”, ku shprehet se me anë të shkresës Nr. 1342/3, datë 10.08.2017 ka informuar Universitetin EPOKA për arsyet e mos pajisjes së ankuesit I. Gj. me Numër Matrikullimi dhe ku i kërkon Universitetit EPOKA të përcjell dokumentacionin plotësues përkatës në mënyrë të procedojmë me dhënien e numrit të matrikullimit.

Lidhur me argumentin në kthim përgjigje të shkresave zyrtare të komunikuara mes institucioneve, vihet re nga QSHA, një përgjigje procedurale, formale ku argumentohen studimet e nivelit Bachelor dhe jo Master për të cilën është kërkuar informacion dhe zgjidhje nga ana institucionit.

Edhe njëherë theksojmë se ankuesi ka përfunduar programin e studimeve të ciklit të parë “Bachelor”, pasi ka plotësuar kushtet për diplomim nga programi i studimit në fjalë. Ju bëj me dije se ankuesi është diplomuar më datë 20.09.2012, ku dhe ka vazhduar studimin “Master i Shkencave” për të cilën nuk është pajisur ende me diplomën përkatëse “Master i Shkencave”.

Theksoj se mos pajisja me numër individual matrikullimi, ka ndodhur për shkak se ende nuk është dhënë nga ana e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA).

Duke qenë se universiteti ka detyrimin ligjor për ta pajisur me dokumentet e përfundimit të studimeve lidhur me Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), konsideroj se ankuesi I. Gj. është subjekt i një trajtimi diskriminues.”.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri:

- të konstatojë diskriminimin e tij;
- verifikimin e kësaj çështjeje dhe ndërhyrjen për të siguruar pajisjen me diplomën dhe dokumentacionin përkatës;
- ndërmarrjen e masave urgjente të nevojshme për të shmangur përsëritjen e kësaj situate në raste të ngjashme.

- Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, përfaqësuesi i ankuesit, Avokat E. C. është kontaktuar nga Komisioneri (nëpërmjet e-mail-eve datë 14.11.2024 dhe datë 03.12.2024; shkresës nr. 1534/2 prot., datë 02.12.2024, si dhe përmes komunikimit telefonik në datat 25.11.2024, 27.11.2024 dhe 12.12.2024) dhe i është kërkuar të plotësojë kriteret formale të ankesës, duke depozituar prova dhe fakte lidhur me shkakun e diskriminimit të pretenduar “*çdo shkak tjetër*”, në mënyrë që të evidentohet se cila është karakteristika e veçantë që mbart ankuesi dhe që prezumohet se ka ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese të pretenduar, të përcaktojë qartë subjektin kundër të cilit ka paraqitur ankesën, si dhe dokumentin e përfaqësimit të ankuesit përpara Komisionerit, në formën e kërkuar nga ligji.

Në përgjigje të kërkesës të mësipërme, përfaqësuesi i ankuesit, Avokat E. C., nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion për plotësimin e ankesës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit

ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Bazuar në deklaratimet e depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri, konstaton se:

Ankuesi më datë 01.09.2007 është regjistruar në programin e studimit “Bachelor” në Fakultetin e Inxhinieri Ndërtimi pranë Institucionit privat arsimor të lartë, Universiteti EPOKA. Më datë 11.07.2011 ka përfunduar studimet dhe është pajisur me diplomë më datë 20.09.2012.

Në datë 13.11.2015 në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit pranë Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në Universitetin EPOKA. Pasi ka plotësuar kushtet për diplomim nga programi i studimit në fjalë më datë 17.04.2018, nuk është pajisur me dokumentacionin përkatës që vërteton përfundimin e studimeve. Nga përfundimi i studimeve në programin Master i Shkencave e në vijim, ankuesi nuk është pajisur nga ana e Universitetit EPOKA me diplomën përkatëse për përfundimin e këtij cikli studimesh.

Referuar kërkesave të depozituara më datë 04.07.2023, si dhe datë 19.08.2023, drejtuar QSHA-së, ankuesi është informuar nga kjo e fundit se nga ana e Universitetit EPOKA nuk është përcjell pranë QSHA-së dokumentacioni për dhënien e numrit të matrikullimit për të, në mënyrë që ai të pajiset me dokumentin e kërkuar.

Sipas ankuesit, fakti që ai nuk ka marrë numër individual matrikullimi, ka ndodhur për shkak se ende nuk i është dhënë nga ana e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA).

Sa më sipër, ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me personat e tjerë që kanë përfunduar të njëjtin cikël arsimor dhe janë pajisur me diplomën përkatëse nga Universiteti EPOKA.

Subjekti ankues, në rastin në fjalë nuk ka bashkëlidhur asnjë dokumentacion për të dokumentuar gjendjen ekonomike apo çdo shkak tjetër.

Pas analizimit sa më sipër, si dhe akteve të depozituara nga subjekti ankues, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e LMD-së, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, lidhur me identifikimin e provueshmërinë e shkaqeve, bazuar në të cilat ankuesi pretendon se është diskriminuar nga QSHA.

Komisioneri vëren se, ankuesi kur citon shkaqet e *gjendjes arsimore*⁵” dhe “*çdo shkak tjetër*⁶”, për të cilat pretendon diskriminimin nga ana e QSHA-së, evidenton faktin se këto shkaqe ai i lidh me *pasojat* që i vijnë nga mosveprimi i këtij institucioni për ta pajisur me numrin individual të matrikullimit dhe për rrjedhojë ai nuk është pajisur edhe me dokumentin përkatës të përfundimit të studimeve të ciklit Master i Shkencave, dhe jo me faktin që ky veprim ka ardhur pikërisht për shkak se ai posedon këto cilësi apo shkaqe apo të jetë motivuar prej tyre.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkaqet sipërcituar, Komisioneri vëren se, *parimisht*, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrijë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi janë gjendja arsimore e ankuesit, dhe çdo shkak tjetër.

Pala ankuese nuk parashtron fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të QSHA-së që të jenë motivuar nga këto shkaqe.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Komisioneri vlerëson se, ndodhemi përpara rastit, kur ankuesi ka pretenduar për paligjshmëri dhe mosveprim të QSHA-së konform parashikimeve ligjore (pa përcaktuar se cili ligj apo akt nënligjor specifikisht është shkelur). Gjithashtu, ankuesi vetëm ka përzgjedhur shkakun e *gjendjes arsimore* dhe *çdo shkak tjetër* në listën e shkaqeve të parashikuara nga Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, por nuk ka dhënë apo argumentuar se si këto shkaqe prezumohet të kenë ndikuar në sjelljen diskriminuese të pretenduar.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkaqeve të pretenduara nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes lidhur me këto shkaqe.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se: “*Ankesa nuk pranohet nëse:, ç) ... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”, ankesa nuk mund të pranohet

⁵ Ankuesi nuk ka depozituar shpjegime, fakte e prova lidhur me provueshmërinë e këtij shkak apo të situatës se si lidhet trajtimi i tij nga QSHA-ja, me këtë shkak.

⁶ Ankuesi nuk ka depozituar shpjegime, fakte e prova lidhur me faktin se cila është karakteristika, apo veçantia që ai mbart dhe që prezumohet që ka ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese të pretenduar dhe si ky shkak lidhet apo ka afektuar sjelljen e QSHA-së ndaj tij.

dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁷.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Së dyti, lidhur me dokumentin e përfaqësimit të ankuesit përpara Komisionerit, në formën e kërkuar nga ligji, evidentohet se:

Ankesa e paraqitur pranë Komisionerit, është depozituar nga ana e Avokatit E. C., në emër të shtetasit I. Gj.

Ligji Nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës Së Shqipërisë”, i ndryshuar, në Nenin 64 “Kuptimi i përfaqësimit”, parashikon se: “Me përfaqësimin një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuari).

Përfaqësimi nuk lejohet kur veprimi juridik duhet, sipas ligjit, të kryhet nga vetë personi.

Nuk mund të vepronjë si përfaqësues personi që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar”.

Neni 70 i Kodit Civil, “Përfaqësimi me prokurë”, përcakton ndër të tjera se: “Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuari, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit”.

Ndërsa Neni 71, parashikon se: “Prokura është e përgjithshme kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagre për të kryer veprime juridike të shumëllojshme, të cilat kanë të bëjnë me një tërësi të drejtash të të përfaqësuarit, përveç atyre që i ka përjashtuar shprehimisht.

Prokura është e posaçme kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagrin për të kryer një ose disa veprime juridike të caktuara, që karakterizohen nga një qëllim i përbashkët”.

Në nenin 4, të LMD, përcaktohet se: “1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.”

Sipas nenit 32, të LMD, përcaktohet se: “ 1. Komisioneri ka kompetencë:a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”;.....3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

⁷ Për analogji citojmë vendimet: nr. 261, datë 28.12.2023; nr. 36, datë 05.02.2024 dhe nr. 241, datë 09.09.2024, të KMD-së.

Referuar nenit 33, të LMD, përcaktohet se: “1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.”

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;”

Bazuar në nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit, rezulton që I. Gj., i cili banon në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në cilësinë e ankuesit, me anë të Prokurës së Posaçme, datë 10.11.2023, i ka dhënë tagrat e përfaqësuesit, Avokatit E. C.. Referuar këtij dokumenti, ankuesi autorizon Avokatin E. C., ndër të tjera për: “Të marrë informacion për institucionet arsimore në vend, Ministria e Arsimit dhe Sportit, në Universitetin Epoka. Të bëjë kërkesa drejt institucioneve përkatëse në Shqipëri...të hartoj dhe tërheq kërkesa, kërkesë padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të shkallës së dytë, në Gjykatën Penale dhe atë të Apelit dhe në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, i jap të drejtë avokatit tim të hartoj dhe tërheqë dokumentacione shkollore në favorin tim...”.

Në analizë të legjislacionit sipërcituar, Prokura e Posaçme e depozituar nga ankuesi, ajo duhet të përmbajë datën dhe vendin e lëshimit të dokumentit, kohëzgjatjen e përfaqësimit, gjeneralitetet e palëve, përshkrimin e tagrave të dhëna, nënshkrimet respektive dhe vulën e personit juridik (nëse i Përfaqësuari është person juridik).

Në rastin konkret, ankuesi, I. Gj., referuar Prokurës së Posaçme të depozituar, ka autorizuar përfaqësuesin e tij ligjor, Avokatin E. C., për të kryer një sërë veprimesh në institucionet arsimore në vend apo gjykatat e Republikës së Shqipërisë, por asnjë moment nuk e autorizon E. C. të paraqesë ankesë në emër të tij apo të ndjekë procedurën e shqyrtimit të saj, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Sakaq, Avokati E. C., nuk është i autorizuar në formën e kërkuar nga legjislacioni sipërcituar, për të përfaqësuar ankuesin pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Bazuar në dispozitat e mësipërme dhe parashikimeve të bëra në ligjin 10221/2021 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se, Avokati E. C., nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë në emër të I. Gj.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 1 dhe 2, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë ankesa nuk mund të pranohet dhe nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 12/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, I. Gj., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja arsimore dhe çdo shkak tjetër)

(Fusha: Arsim)